



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-27/2008,” e konform nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

Për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2021 shuma prej 923,813.21€ të barten për shfrytëzim në vitin fiskal 2022 .

Neni 1.

1.1 Komuna e Suharekës gjatë vitit 2021 ka tejkalluar planin buxhetor të të hyrave vetanake, në shumë prej **374,230.40€**.

1.2 Në vitin 2021, të hyrat vetanake kanë qenë të planifikuar, **1,812,956,00€**, ndërsa gjatë tërë vitit fiskal 2021, janë grumbulluar gjithsej shuma prej **2,187,186.40€**.

1.3 Mjetet e grumbulluara si tepriçë prej **374,230.40€** dhe shuma e pa shpenzuar që duhet bartur në vitin fiskal 2022 prej **549,582.84€** e si total i bartjes është shuma prej **(374,230.40€ +(plus) 549,582.84€)=923,813.24€** shumë në fjalë duhet të sistemohet në programin SIMFK-së, dhe të lejohet për alokim, sipas kërkesës tonë në këto programe dhe kategori ekonomike.

Tabela 1.

	Mallra & Sherbime	Komunali	Subvencione Transfere	Invstime Kapitale	TOTAL:
Zyra e Kryetarit (16012)			6.679.00		6,679.00
Administrata (16312)	10,000.00				10,000.00
Zyra e Kuvendit (16912)	4,081.20				4,081.20
Inspekcioni(16623)				10,010.97	10,010.97
Buxheti dhe Financa(17512)	6,789.26				6,789.26
Sherbimet Publike dhe Emergjente (18012)		20,485.98		268,015.91	228,501.89
Bujqësia e Zhv.Rural(47012)	16,642.86		1,450.00	84,935.56	103,028.42
Planifikim e Urbaniz. (66365)	6,432.73			86,049.07	92,481.80
Administra e Shëndetësis(73021)	4,429.84		100,000.00		104,429.84
Shëndeti primar-QKMF (73750)				25,000.00	25,000.00
Kultur Rini e Sport (85012)	12,854.09		80,000.00	70,302.58	163,156.67
Adminstrata- Arsimit (92060)	10,019.79	10,583.19		93,849.78	114,452.76
Arsimi parafillor(92430)		5,000.52		-	5,000.52
Arsimi Fillor(93330)		7,000.00		-	7,000.00
Arsimi I mesem(94530)	10,000.00	13,200.91			23,200.91
TOTAL:	81,249.77	56,270.60	188,129.00	598,163.87	923,813.24

Tabela 2.

Programi	Kodi i nën-programit	Kodi Funkcional	Fondi Burimor	Kategoria ekonomike	PROJEKTET KAPITALE	BARTJA 2021
Inspekcioni	16623	0411	22	30	40873 RRENIMI DHE TRAJTIMI I OBJEKTEVE PA LEJE	10,010.97
					TOTAL KAPITALE :	10,010.97
Shërbimet Publike dhe Emergjente	18012	0451	22	30	40903 KRIJIMI I HAPSIR.TE GJELBRUARA	6,203.20
Shërbimet Publike dhe Emergjente	18012	0451	22	30	43510 Projekte me bashkefinansim	32,003.10
Shërbimet Publike dhe Emergjente	18012	0451	22	30	49230 RREGULLIMI DHE SANIMI I RRUGEVE LOKALE NE KOMUNE	30,000.00
Shërbimet Publike dhe Emergjente	18012	0451	22	30	50525 NDERTIMI DHE RENOVIMI I MULLIRIT TE VJETER NE BRESHANC	10,000.00
Shërbimet Publike dhe Emergjente	18012	0451	22	30	50568 NDERTIMI I RRUGEVE: "SADRI SHASHA", "SADIK SEJDA", "HAKI SOK	10,000.00
Shërbimet Publike dhe Emergjente	18012	0451	22	30	51197 PUNIMI I UJESJELLSIT NE PAPAQ,PEQAN,BLLAC DHE GREJKOC	12,156.00
Shërbimet Publike dhe Emergjente	18012	0451	22	30	51231 NDE.I INFRASE VARREZAVE TE QYTETIT NE SUHAREKE	105,000.00
Shërbimet Publike dhe Emergjente	18012	0451	22	30	47504 RREGULLIMI I RRUGES BRIGADA 123,QENDER-SUHAREKE	10,521.61
Shërbimet Publike dhe Emergjente	18012	0451	22	30	49131 MBIQYRJA E PROJEKTEVE INVESIVE	10,005.00
Shërbimet Publike dhe Emergjente	18012	0451	22	30	49203 RREGULLIMI I KANALIZIMIT NE BLLACE	2,127.00
					TOTAL KAPITALE :	228,015.91
Bujqësi dhe Zhvillim Rural	47012	0421	22	30	50593 NDERTIMI I SISTEMIT TE UJITJES PER SIPERFAQET BUJQESORE (KAN	5,795.30
Bujqësi dhe Zhvillim Rural	47012	0421	22	30	51232 SHP.RR."LUIGJ NIK "DHE KANA"DUBIQAKUT" NE SUHAREKE	35,000.00
Bujqësi dhe Zhvillim Rural	47012	0421	22	IRI	SHPRONSIMI I TOKËS NË DAMPER-BALLKAN NË SHIROKË	44,140.26
					TOTAL KAPITALE :	84,935.56
Shërbimi Kujdesit primar shëndetësor	73750	0721	22	30	50507 BLERJA E PAJISJEVE DHE MONTIMI I SISTEMIT TE MENAXHIMIT TE R	5,000.00
Shërbimi Kujdesit primar shëndetësor	73750	0721	22	30	50510 BLERJA E PAJISJEVE LABORATORIKE SI: ULTRAZA PER GJINOKOLOGJI	10,000.00
Shërbimi Kuj. primar shëndetësor	73750	0721	22	30	50716 NDERTIMI DHE FUNKSIONALIZIMI I QMF-MUSHTISHT	10,000.00
				30	TOTAL KAPITALE :	25,000.00
Shërbimet Kulturore,rini e sport	85012	0820	22	30	48092 NDERTIMI I SHTEPIS MUZE "FADIL VATA" NE SALLAGRAZHDE	10,000.00
Shërbimet Kulturore,rini e sport	85012	0820	22	30	49243 NDERTIMI I KULLES PER DESHMORET E FSHATIT BLLACE	10,000.00
Shërbimet Kulturore,rini e sport	85012	0820	22	30	50594 RENOVIMI DHE MIREMBAJTJA E LAPIDAREVE DHE VARREZAVE TE DESH	15,000.00
Shërbimet Kulturore,rini e sport	85012	0820	22	30	50596 RREGULLIMI I PARQEVE REKREATIVE SPORTIVE NE SOPIJE, GELANCE,	3,605.80
Shërbimet Kulturore,rini e sport	85012	0820	22	30	47939 NDERTIMI I LAPIDARIT PER VIKTIMAT E VITEVE 1912-1945	1,000.00
Shërbimet Kulturore,rini e sport	85012	0820	22	30	48079 RENOVIMI DHE MIREMBAJTJA E LAPIDAREVE	5,204.26

Shërbimet Kulturore,rini e sport	85012	0820	22	30	49240 RENOVIMI DHE MIREMBAJTJA E LAPIDAREVE DHE VARREZAVE TE DESH	20,706.41
Shërbimet Kulturore,rini e sport	85012	0820	22	30	49243 NDERTIMI I KULLES PER DESHMORET E FSHATIT BLLACE	4,786.11
				30	TOTAL KAPITALE :	70,302.58
Urbanizmi dhe Planifikimi Urban	66365	0620	22	30	49238 SINJALIZIMI RRUGOR DHE SISTEMI I UNIFIKUAR I ADRESAVE	15,000.00
Urbanizmi dhe Planifikimi Urban	66365	0620	22	30	50509 RENOVIMI I OBJEKTEVE PUBLIKE DHE KOLEKTIVE TE BANIMIT "BANES	15,000.00
Urbanizmi dhe Planifikimi Urban	66365	0620	22	30	44586 HARTIMI DHE REVIDIMI I PROJEKTEVE	10,222.07
Urbanizmi dhe Planifikimi Urban	66365	0620	22	30	47526 TRAJTIMI I DEPONIVE ILEGALE	10,010.00
Urbanizmi dhe Planifikimi Urban	66365	0620	22	30	48270 SHENJEZIMI HORIZONTAL VERTIKAL, SISTEMI UNIFIKUAR I ADRESAVE	5,817.00
Urbanizmi dhe Planifikimi Urban	66365	0620	22	30	49643 TRAJTIMI I DEPONIVE ILEGALE -BLLACE, STUDENQAN, BUDAKOVE, DU	10,000.00
Urbanizmi dhe Planifikimi Urban	66365	0620	22	30	89823 HART.HARM.DOKU.PLAN.HAPSIN.	20,000.00
					TOTAL KAPITALE :	86,049.07
Administrata e Arsimit	92060	0980	22	30	50504 MJETE KONKRETIZUESE (KABINETE): BLLACE, "7 MARS"-SUHAREKE,	11,000.00
Administrata e Arsimit	92060	0980	22	30	50603 NDERTIMI I SALLES SPORTIVE NE BUDAKOVE	10,000.00
Administrata e Arsimit	92060	0980	22	30	50604 NDERTIMI I SALLES SPORTIVE NE SALLAGRAZHDE	30,849.78
Administrata e Arsimit	92060	0980	22	30	50605 INSTALIMI DHE MIREMBAJTJA E KAMERA VE TE SIGURISE NE SHKOLLA	2,000.00
Administrata e Arsimit	92060	0980	22	IRI	Ndërtimi i sallës së sporteve në Grejkoc	40,000.00
					TOTAL KAPITALE :	93,849.78
624- KUVENDI KOMUNAL SUHAREKË					TOTAL KAPITALE :	598.163.87

Neni 2

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendim i njeiti do të shërbej për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake të mbetura pa u shfrytëzuar nga viti 2020 dhe viti 2021, e të cilat do të shfrytëzohen dhe shpenzohen në vitin fiskal 2022.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr-

016-12176

Më datë

28/02/2022



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKË



S T A T U T I
I
QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË
FAMILJARE NË SUHAREKË

Suharekë-2022

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e në mbështetje të nenit 45, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/07 maj 2013", e konform nenit 6, të Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) Nr. 04/2020 Kujdesi Parësor Shëndetësor dhe nenit 15 lidhur me nenin 29, pika 2, lidhur me nenin 47, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën 28.02.2022 miratoi;

STATUTIN E QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE NË SUHAREKË

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME;

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Statut rregullohen: dispozitat e përgjithshme, emërtimi dhe selia, veprimtaria e QKMF-së, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm institucional, mbikëqyrja e QKMF-së, aktet e përgjithshme të QKMF, pronësia dhe financimi, transparencja në punë, konfidenca profesionale dhe afariste, organizimi sindikal, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së kujdesit shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (në tekstin e mëtejme: QKMF).

Neni 2

Përkufizimet

1. Çdo herë kur në këtë Statut përdoren, termet vijuese kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç rasteve kur konteksti ku paraqitet termi i tillë tregon qartë se ka kuptim tjetër:

1.1 **Kuvendi Komunës**- është organi më i lartë i komunës që përbëhet prej anëtarëve të tij të zgjedhur.

1.2 **Komunë**- do të thotë njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, e përbërë nga qytetarët e komuniteteve në një territor të caktuar të përcaktuar me ligj;

1.3 **Themelues**- do të thotë Kuvendi i Komunës i cili ka të drejtë të themelojë institucionin shëndetësor në pajtim me Ligjet e aplikueshëm në Republikën e Kosovës;

1.4 **MSH**- do të thotë Ministria e Shëndetësisë

1.5 **QKMF**-do të thotë Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

1.6 **QMF**- do të thotë Qendra e Mjekësisë Familjare

1.7 **AMF**- do të thotë Ambulantë e Mjekësisë Familjare

1.8 **KPSH**- do të thotë Kujdesi Parësor Shëndetësor Publik

1.9 **SSSH**- do të thotë Strategjia Sektoriale Shëndetësor 2017-2021

1.10 **SISH**- do të thotë Sistemi Informativ Shëndetësor

1.11 **ZHVP**- do të thotë Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

1.12 **Votim i shumicës**- do të thotë votim për të cilin kërkohet miratimi i më shumë se gjysmës së anëtarëve të përgjithshëm dhe votim në mbledhjen në të cilën shqyrtohet propozimi.

Neni 3 Statusi i QKMF-së

1. QKMF-ja ka statusin e personit juridik publik, me cilësi të autoritetit punëdhënës, ku organizohet, ofrohet dhe zbatohet Kujdesi Parësor Shëndetësor Publik (në tekstin e mëtejme: KPSH).
2. Themelues i QKMF-së është Kuvendi i Komunës në Suharekë.
3. QKMF-ja në Komunën e Suharekës për herë të parë ka filluar punën në vitin 1930 dhe është emërtuar “Punkti i parë shëndetësor parazitologjisë” deri në viti 1935 nga 1936 është emërtuar “Stacion higjienë Sanitar” deri në vitin 1944 nga ky vit është emërtuar “Ambulantë e parë shëndetësore” deri në vitin 1954 nga viti 1955 është emërtuar “Shtëpia popullore e shëndetit” deri në vitin 1965 nga viti 1966 është emërtuar “Shtëpia e shëndetit” deri në vitin 2003 nga viti 2004 është emërtuar “Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Suharekë” (në tekstin e mëtejme QKMF) dhe ende vazhdon punën.
4. QKMF-ja në Komunën e Suharekës do ta shënojë ditën botërore të “Mjekut Familjar” për çdo viti me datën 19.05 (si ditë të QKMF-së).
5. Për caktimin e aktiviteteve për çdo vit do të nxjerr vendim Këshilli Drejtues i QKMF-së në koordinim me MSH.

Neni 4 Emërtimi

1. Emri i institucionit është: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “REXHEP KUÇI” në Suharekë.
2. Shenja njohëse e këtij institucioni është unike për të gjitha QKMF-të në Republikën e Kosovës dhe miratohet nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, në bazë të procedurave ligjore.
3. Emërtimi i QKMF, QMF dhe AMF duhet të jetë i mbishkruar qartë në hyrje të institucionit shëndetësor përkatës të KPSH-së.
4. Për ndryshimin e selisë së QKMF-së vendos themeluesi, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 5 Selia

Selia e Qëndresë Kryesore të Mjekësisë Familjare “REXHEP KUÇI” në Suharekë gjendet në Rr. “Luigj Gurakuqi” në Suharekë.

Neni 6 Vula

1. QKMF-ja posedon vulën e saj që në qarkullimin juridik paraqitet si Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Rexhep Kuçi”.

2. Vula është në formë të rrumbullakët dhe ka dimension 3.5 cm (35 mm).
 - 2.1. Rrethi i parë: Republika e Kosovës;
 - 2.2. Rrethi i dytë: Komuna e Suharekës;
 - 2.3. Rrethi i tretë: QKMF “RXHEP KUÇI” në Suharekë;
 - 2.4. Në mes të vulës është logoja unike për të gjitha QKMF-të në Republikën e Kosovës.
3. QKMF-ja posedon vulën katrore, me dimensione 5.5 cm x 3 cm. që përmban emërtimin, selinë dhe hapësirën për evidentimin e numrit dhe të datës së pranimit të dokumentit.
4. Vula duhet të përmbajë emërtimin e institucionit, sipas këtij Statuti dhe të jetë në gjuhët të cilat janë në përdorim zyrtar në Republikën e Kosovës.
5. Për numrin e vulave, mënyrën e përdorimit dhe autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtje të vulës, vendos Drejtori i QKMF-së.
6. Çdo vulë ka numër identifikues.

Neni 7

Veprimtaria

1. Veprimtaria e QKMF-së përfshinë ofrimin e shërbimeve shëndetësore në KPSH për popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës.
2. Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve të Komunës së Suharekës, t’u ofrojë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse, efikase dhe në vazhdimësi individit dhe familjes në të gjitha fazat e jetës, bazuar në të dhëna shkencore, përmes mjekut familjar si mjek i përzgjedhur i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuesit e shërbimeve në sistemin shëndetësor dhe njëherit pikë referuese për specialistët konsultantë në KPSH dhe në nivelet tjera të kujdesit shëndetësor.
3. Sipas SSSH 2017-2021 dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, ekipi i mjekësisë familjare i përbërë nga një mjekë familjar dhe dy infermiere familjare ofron shërbime shëndetësore për 2000, banorë sipas shtrirjes territoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF-së.
4. Standardet në mjekësinë familjare sipas këtij statuti, do t’i nënshtrohen revidimit periodik nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.
5. Shërbimet shëndetësore në QKMF-në “Rexhep Kuçi” në Suharekë sigurohen dhe zbatohen nga profesionistët shëndetësor të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara në Ligjin për shëndetësi:
 - 5.1. Specialist i Mjekësisë Familjare;
 - 5.2. Doktor i Mjekësisë;
 - 5.3. Doktor i Stomatologjisë;
 - 5.4. Specialist i pedodoncisë dhe preventivës;
 - 5.5. Farmacist i diplomuar – magjistër i farmacisë;

- 5.6. Specialist i Biokimisë klinike;
 - 5.7. Infermier i/e diplomuar;
 - 5.8. Mami e diplomuar;
 - 5.9. Teknik laborant;
 - 5.10. Teknik i farmacisë;
 - 5.11. Teknik/asistent i stomatologjisë;
 - 5.12. Radiologu dhe tekniku i radiologjisë në institucionet ku funksionon kabineti i Rtg;
 - 5.13. Profesionistët shëndetësorë të tjerë me kualifikim të mesëm dhe të lartë, të përcaktuar në regjistrin zyrtar të Ministrisë së shëndetësisë;
 - 5.14. Bashkëpunëtorët profesional me shkollim jashtë lëmisë së mjekësisë, të evidentuar në regjistrin zyrtar me vendim të Ministrit të Shëndetësisë, në bazë të propozimit të Odës përkatëse të profesionistëve sipas Ligjit të Shëndetësisë.
6. Në QKMF-në ku funksionojnë maternitetet, është i domosdoshëm Gjinekologu dhe Neonatologu ose Pediatri.
7. Specialistët nga lëmit e tjera, mund të vazhdojnë punën në KPSH si konsulent të Mjekëve Familjarë deri në pensionim.
8. Konsulentët në KPSH sipas paragrafit 7, të këtij neni ofrojnë shërbime konsultative në QKMF dhe QMF.
9. Mjeku familjar duhet të jetë i certifikuar për të ofruar shërbime me Ultrazë.

Neni 8 Shërbimet

1. QKMF-ja kryen këto shërbime të kujdesit parësor shëndetësor:
- 1.1. Shërbimet e promovimit shëndetësor; përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin brenda institucioneve dhe në komunitet;
 - 1.2. Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese;
 - 1.3. Shërbimet esenciale kurative dhe ndërhyrje të vogla kirurgjike;
 - 1.4. Shërbime të kujdesit akut dhe urgjent;
 - 1.5. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet kronike;
 - 1.6. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë, adoleshentë dhe të rinjë;
 - 1.7. Shërbimet e shëndetit riprodhues;
 - 1.8. Shërbimet e shëndetit oral dhe parandalues;
 - 1.9. Shërbimet e shëndetit mendor;
 - 1.10. Shërbimet e kujdesit shtëpiak përfshirë shërbimet e kujdesit ndaj nënës dhe fëmijës, kujdesi paliativ si dhe kujdesi shtëpiak bazuar në nevojat e popullatës dhe prioritetet e shëndetit publik;
 - 1.11. Shpërndarjen e barërave nga lista esenciale.

Neni 9 Përfaqësimi

1. QKMF-ja në Suharekë është institucion, i cili bën pjesë në rrjetin e institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor publik në Republikën e Kosovës.

2. QKMF-ja kryen dhe ofron shërbime të kujdesit parësor shëndetësor për qytetarët e komunës, sipas dispozitave ligjore që janë në fuqi.
3. Për nënshkrimin e kontratave, me të cilat fitohen, tjetërsohen apo shiten objektet dhe pajisjet kapitale, me ose pa vlerë ri-gjeneruese të QKMF-së, duhet të ketë së pari propozimin e menaxhmentit të QKMF-së dhe aprovimin e Kuvendit të Komunës së Suharekës, në bazë të ligjeve në fuqi.
4. Drejtori i QKMF-së ka të gjitha autorizimet për përfaqësimin juridik dhe afarist, brenda veprimtarisë së QKMF-së me pëlqim të Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Suharekës.

Neni 10

Organizimi i QKMF-së

1. QKMF-ja me qëllim të ofrimit të përkujdesjes shëndetësore për banorët e vet, organizohet me këto njësi përbërëse:

1.1. Departamenti i Mjekësisë Familjare me këtë përbërje:

- 1.1.1 Sektori i Mjekësisë Familjare;
- 1.1.2 Njësia e SISH;
- 1.1.3 Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit;
- 1.1.4 Sektori i Shëndetit Oral Preventiv;
- 1.1.5 Sektori i Kujdesit Urgjent;
- 1.1.6 Sektori konsultativë dhe Diagnostikë;
- 1.1.7 Shërbimet konsultative;
- 1.1.8 Kabineti Radiologjik;
- 1.1.9 Laboratori;

1.2. Departamenti i Administratës së QKMF-së në Suharekë do të organizohet në:

- 1.2.1 *Zyra e personelit;*
- 1.2.2 *Zyra Juridike;*
- 1.2.3 *Zyra për buxhet dhe financa;*
- 1.2.5 *Zyra për shërbime teknike.*

1.3. Barnatorja Qendrore:

1.3.1 Barnatorja qendrore është njësi organizative e QKMF e cila themelohet dhe funksionon sipas ligjeve dhe akteve nën ligjore që rregullojnë veprimtarinë farmaceutike;

1.3.2 Në QMF/AMF funksionojnë barnatoret doracake të cilat menaxhohen, furnizohen dhe monitorohen nga barnatorja Qendrore në QKMF;

1.3.3 Nga barnatorja qendrore dhe njësitë e saja në QMF/AMF shpërndahen barnat nga Lista Esenciale e Barnave, e lejuar nga Ministria dhe të përshkruara në recetat unike, nga Mjekët e Sektorit të Mjekësisë Familjare dhe barnat të cilat siguron Komuna e Suharekës nga të hyrat vetanake të Komunës;

1.3.4 Me barnatoren qendrore udhëheq Shefi i Barnatores.

2. Lista e Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulancave të Mjekësisë Familjare (AMF) në kuadër të QKMF-së në Suharekë përbën Rrjetin e institucioneve të KPSH në Komunën e Suharekës.

3. Rrjeti i Institucioneve shëndetësore sipas paragrafit 2 do të jetë objekt i revidimit periodik që do të ndërmerret nga Kuvendi Komunal i Suharekës me pëlqim të Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 11

Sistemi i Informimit Shëndetësor në QKMF

1. QKMF-ja në Suharekë zbaton sistemin unik të informimit shëndetësor, ashtu siç është paraparë me Ligjin e Shëndetësisë dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë lëmi.

2. Departamenti i SISH-it në Ministrinë e Shëndetësisë në koordinim me QKMF-në bënë implementimin e Sistemit dhe funksionalizimin e tij në të gjitha nivelet e institucioneve të KPSH-së.

3. QKMF-ja obligohet të përdor Sistemin Informativ Shëndetësor nga MSH-ja për të gjitha llojet e shërbimeve të ofruara duke përfshirë edhe bashkë pagesat.

4. Në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale çdo profesionist shëndetësor obligohet që të ruaj konfidencialitetin e të dhënave për të gjitha veprimet e ndërmarra me Sistemin e Informimit Shëndetësor.

Neni 12

Këshilli Drejtues dhe Struktura

1. Këshilli Drejtues i QKMF-së në Suharekë ka 7, anëtarë dhe ka këtë përbërje:

- 1.1 Drejtori i QKMF-së, i cili e kryeson Këshillin;
- 1.2 Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare;
- 1.3 Udhëheqësi i Departamentit të Administratës;
- 1.4 Koordinatori për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore;
- 1.5 Kryeinfermieri i QKMF-së;
- 1.6 Përfaqësuesi i sindikatës në cilësinë e vëzhguesit;
- 1.7 Përfaqësues nga Këshilli i pacientëve;

2. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjat aq sa zgjat kontrata e punës së tyre, por mund të përfundojë edhe më parë në rastet kur:

- 2.1 Anëtari/ja ndërprejnë marrëdhënien e punës në QKMF;
- 2.2 Anëtari/ja i/e Këshillit Drejtues jep dorëheqje;
- 2.3 Anëtari/ja i/e Këshillit Drejtues mungon pa arsye në mbledhje të Këshillit, brenda vitit, tri herë radhazi;
- 2.4 Anëtari/ja nuk respekton detyrat e punës.

Neni 13

Kompetencat dhe Detyrat e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues kryen detyrat të përcaktuara me këtë Statut dhe vendos për:

- 1.1 Veprimtarinë e QKMF dhe vërteton politikën punuese të QKMF-së;

- 1.2 Propozon ndryshimet e Statutit të QKMF-së përmes DSHMS-së, të cilat propozime pas dhënies së pëlqimit nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe miratuar nga Kuvendi i Komunës së Suharekës;
 - 1.3 Miraton raportin e punës dhe llogaritë vjetore të QKMF-së dhe raporton në Divizionin e Kujdesit Parësor Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë përmes Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Suharekës.
 - 1.4 Vendos për shfrytëzimin e mjeteve në kuadër të ligjit;
 - 1.5 Përgatitë programin e punës dhe planin financiar;
 - 1.6 Harton rregulloren për organizimin e punës në QKMF-në dhe aktet tjera në përputhshmëri me ligjin dhe me këtë Statut;
 - 1.7 Harton planin e burimeve njerëzore sipas propozimit të Këshillit Profesional brenda resurseve të disponueshme dhe në përputhje me politikat e MSH;
 - 1.8 Miraton planin vjetor për ZHVP të kuadrit mjekësor dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor dhe siguron aplikimin e tij;
 - 1.9 Bënë planin dhe programin e masave për mbrojtje në punë;
 - 1.10 Emëron komisione të përkohshme dhe organe tjera punuese;
 - 1.11 Vendos për sigurimin e pasurisë së QKMF-së, sigurimin e punëtorëve në bazë të ligjit;
 - 1.12 Propozon ndërtimin dhe adaptimin e objekteve, si dhe për burimet e mjeteve për kryerjen e këtyre punimeve duke u bazuar në politikën shëndetësore të MSH;
 - 1.13. Kryen edhe punë të tjera të cilat i janë lënë në kompetence, me këtë statut dhe aktet tjera normative të QKMF-së.
2. Këshilli Drejtues i QKMF-së i kryen detyrat brenda përgjegjësisë të veta në mbledhje.
 3. Mbledhja e Këshillit Drejtues është e vlefshme nëse të gjithë anëtarët janë njoftuar me kohë dhe në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
 4. Njoftimi për mbledhjen duhet të ketë rendin e ditës dhe duhet të dorëzohet me dorë së paku tre ditë para mbledhjes, në mënyrë elektronike apo me çfarëdo mënyre tjetër, të cilat sigurojnë pranimin me kohë në mbledhje.
 5. Këshilli Drejtues merr vendime me shumicë të votave të anëtarëve të përgjithshëm të Këshillit Drejtues.
 6. Në të gjitha mbledhjet e Këshillit Drejtues, çdo anëtarë, përfshirë edhe kryesuesin, kanë nga një votë, por kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi (vota e kryesuesit është vendimtare).
 7. Anëtari i Këshillit Drejtues nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij apo saj, ka interes personal apo material.
 8. Çdo anëtar i Këshillit Drejtues duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është prezent.

9. Abstenimet regjistrohen me qëllim të themelimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.

10. Në mbledhjen e Këshillit Drejtues mbahet procesverbali, të cilin e miratojnë pjesëmarrësit në takimin e radhës.

11. Këshilli i pacientëve:

11.1 Përfaqëson interesat e pacientëve në Institucionet e KPSH-së;

11.2 Organizon pacientët për të mbështetur institucionin në ofrimin e kujdesit shëndetësor;

11.3 Krijon mekanizmat e komunikimit midis MSH dhe pacientëve.

Neni 14 **Drejtori i QKMF-së**

1. QKMF-në e udhëheq Drejtori i QKMF-së.

2. Drejtori përfaqëson, prezanton QKMF-në dhe është përgjegjës për menaxhimin dhe ligjshmërinë e punës.

3. Drejtori i QKMF-së i përgjigjet për menaxhimin mjekësor, administrativ dhe financiar të të gjitha funksioneve të shërbimeve në QKMF, Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Suharekës.

4. QKMF-të që kanë një personel mbi 100 të punësuar kanë të drejt të kenë Zëvendësdrejtorin.

5. Zëvendësdrejtori ndihmon në ushtrimin e detyrave të përditshme dhe vepron në emër të Drejtorit të QKMF-së në mungesë të tij.

Neni 15 **Procedura për zgjedhjen e Drejtorit**

1. Procedurat për përzgjedhjen e drejtorit të QKMF-së i udhëheqë Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Suharekës.

2. Drejtor i QKMF-së duhet të zgjidhet personi, i cili i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të punësimit, në bazë të ligjeve në fuqi:

2.1 Të jetë Mjek specialist nga Mjekësia Familjare;

2.2 Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë përvojë të dëshmuar në procesin e implementimit të mjekësisë familjare ose kandidatët me shkollim profesional në fushën e menaxhimit shëndetësor;

2.3 Kandidati për Drejtor duhet t'i ketë 5, vite përvojë pune në sistemin shëndetësor publik prej tyre 3, vite përvojë pune në pozita menaxheriale.

3. Vendimin për publikimin e konkursit për Drejtor të QKMF-së e merr Kryetari i Komunës.

4. Procedurat për përzgjedhjen e Zëvendësdrejtorit e udhëheqë Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Suharekës.

Neni 16

Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësit e Drejtorit të QKMF

1. Drejtori i QKMF-së është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punë dhe afarizmin e QKMF-së si dhe për punën profesionale të QKMF-së e cila duhet të organizohet dhe udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe akteve të tjera normative.
2. Drejtori i QKMF-së është përgjegjës për përkujdesjen efikase dhe efektive të shëndetësisë parësore publike për të gjithë banorët e Komunës Suharekës dhe përgjigjet për detyrat që vijojnë:
 - 2.1 Në pajtim me Politikën Shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi Nr. 04/L-125 dhe SSSH, Udhëzimit Administrativ për KPSH, Drejtori i QKMF i propozon për miratim, Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Suharekës, Planin e Punës dhe Buxhetin e QKMF-së për vitin vijues;
 - 2.2 Drejtori është përgjegjës për implementimin e Planit të burimeve njerëzore;
 - 2.3 Nën mbikëqyrjen dhe autorizimin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Suharekës zbaton buxhetin e QKMF-së;
 - 2.4 Është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF;
 - 2.5 Avancoon punën ekipore;
 - 2.6 Mundëson Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF-së;
 - 2.7 Menaxhon implementimin e standardeve të cilësisë;
 - 2.8 Kontribuon në zhvillimin dhe zbatimin e sistemit të informimit shëndetësor të QKMF-së.
3. Programi i punës së QKMF-së realizohet duke u bazuar në politikat zhvillimore të sistemit shëndetësor të hartuara nga MSH-ti.
4. Në programin vjetor të punës duhet të përcaktohen objektivat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura në QKMF si:
 - 4.1 Plani vjetor i punës;
 - 4.2 Organizimi dhe udhëheqja;
 - 4.3 Burimet njerëzore;
 - 4.4 Plani financiar;
 - 4.5 Raportet e punës mujore, vjetore dhe raportet financiare.
5. Për kryerjen e punëve të tij, drejtori i QKMF-së i përgjigjet Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Suharekës.

Neni 17

1. Drejtori ka për detyrë që gjatë punës dhe vendimeve që i merr Këshilli Drejtues, të tërheqë vëmendjen:
 - 1.1 Nëse aktet e propozuara janë në kundërshtim me ligjet relevante përkatësisht, në kundërshtim me aktet e përgjithshme të QKMF-së;
 - 1.2 Nëse akti i propozuar është në kundërshtim me Programin e punës së QKMF-së;
 - 1.3 Nëse akti i propozuar nuk i kontribuon qëllimit.

Neni 18

Trupat e QKMF-së

1. Për përmbushjen e detyrave të veçanta, Këshilli Drejtues, përmes drejtorit të QKMF-së, formon Trupa Profesionale në QKMF, siç janë:

- 1.1 Këshilli Profesional;
- 1.2 Komisioni Disiplinor i QKMF-së;
- 1.3 Komisioni i Ankesave i QKMF-së;
- 1.4 Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore;
- 1.5 Komisioni Etiko-Profesional.

2. Anëtarët e trupave profesionale emërohen nga Drejtori i QKMF.

3. Këshilli Drejtues, përmes Drejtorit të QKMF-së, sipas nevojës, mund të formojë edhe trupa të tjerë profesional për nevoja të QKMF-së.

Neni 19

Këshilli Profesional

1. Këshilli Profesional është trup këshillëdhënës i Drejtorit të QKMF.

2. Këshilli Profesional përbëhet nga Udhëheqësit e Departamenteve, Udhëheqësit e Sektorëve dhe Njërive, Shefit të Barnatores Qendrore si dhe Kryeinfermieri/ja e QKMF-së, sipas nenit 12 të këtij Statuti.

3. Kryetar i Këshillit Profesional, sipas detyrës zyrtare, është Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare të QKMF-së.

4. Këshilli Profesional harton Rregulloren e punës për punën e Këshillit.

5. Kryetari i Këshillit Profesional i kryen këto punë:

- 5.1 Përgatit thërret dhe udhëheq takimet e Këshillit Profesional;
- 5.2 Verifikon rendin e ditës së takimeve;
- 5.3 Siguron mbajtjen e procesverbalit të takimeve.

6. Kryetari i Këshillit Profesional është i obliguar ta thërrasë mbledhjen brenda 3 (tri) ditëve, nga dita kur këtë e kërkon drejtori i QKMF-së.

7. Këshilli Profesional i QKMF-së, përveç detyrave të parapara me ligj, i kryen edhe këto detyra:

- 7.1 Shqyrton dhe vendos për nevojën dhe arsyet profesionale të implementimit të metodave dhe procedurave të reja diagnostifikuese dhe terapeutike;
- 7.2 Propozon Këshillit Drejtues dhe drejtorit marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë;
- 7.3 Propozon strukturën e mbikëqyrjes së brendshme, lidhur me punën e punëtorëve shëndetësor si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale;
- 7.4 Shqyrton nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe i propozon drejtorit dërgimin e punëtorëve shëndetësor në përsosje profesionale

7.5 Kërkon raport me shkrim nga profesionistët shëndetësor për njohuri të fituara nga ZHVP;

7.6 Shqyrton dhe vendos për çështje të tjera, të cilat drejtori ia parashtron Këshillit Profesional.

Neni 20

Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore

1. Në QKMF-në funksionon Komiteti për Siguri të Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore.

2. Komiteti për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore (në vazhdim vetëm Komiteti) është një ekip multi-disciplinar i cili përbëhet nga:

2.1.1 Drejtori i institucionit;

2.1.2 Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare;

2.1.3 Udhëheqësi i departamenti të administratës në QKMF;

2.1.4 Koordinatori për sigurimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore;

2.1.5 Kryeinfermieri në QKMF;

2.2 Varësisht nga institucioni shëndetësor, ky komitet mund të ketë edhe anëtarë të tjerë;

2.3 Detyrat dhe përgjegjësitë e komitetit janë të bazuara në dispozitat e statutit të institucionit shëndetësor.

Neni 21

Komisioni Etik-Profesional

Komisioni Etik-Profesional është trup i cili denoncon rastet e shkeljeve sipas ligjit për odat e profesionistëve shëndetësor.

Neni 22

Detyrat dhe përgjegjësit trupave tjerë

Detyrat dhe përgjegjësitë e trupave tjerë përcaktohen me aktet nënligjore, të nxjerra nga Këshilli Drejtues i QKMF-së, përmes Drejtorit të QKMF-së, nëse ato nuk janë të përcaktuara me akte të tjera nga MSH.

Neni 23

Organizimi sindikal

1. Në QKMF-në mund të organizohet organizimi sindikal i pavarur, që krijohet si bashkim vullnetar të të punësuarve, qëllimi i të cilave është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave ligjore dhe interesave ekonomike, sociale dhe profesionale të anëtarëve të tyre të garantuara me Ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës si dhe me Konventën ndërkombëtare të Punës.

2. Në rast greve të punëtorëve në QKMF-në në Suharekë duhet të sigurohet kryerja e shërbimeve dhe detyrave të punës emergjente.

Neni 24

Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

1. Institucionet shëndetësore në KPSH janë të obliguara që të mundësojnë dhe përkrahin zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punëtorëve të tyre shëndetësorë.
2. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional është i obligueshëm për të gjithë profesionistët shëndetësorë në KPSH, dhe zbatohet sipas planprogramit, të miratuar nga Odat e Profesionisteve Shëndetësorë.
3. Për zhvillimin e aktiviteteve, nga paragrafi 2 i këtij neni përgjegjës janë Koordinatorët dhe trajnuesit në Programet e Mjekësisë Familjare dhe të Infermierisë Familjare, të cilët duhet të kenë përgatitje adekuate akademike dhe profesionale dhe caktohen sipas Termave të Referencës të hartuara nga Ministria e Shëndetësisë.
4. Financimi i ZHVP të profesionistët shëndetësor bëhet nga buxheti i QKMF-së dhe burime të tjera bazuar në aktet normative në fuqi.

Neni 25

Llojet e mbikëqyrjes në QKMF

1. QKMF-ja i nënshtrohet mbikëqyrjes së brendshme dhe të jashtme në pajtim me dispozitat në fuqi që sigurohet përmes Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në Komunën e Suharekës dhe autoriteteve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.
2. Mbikëqyrja e brendshme e punës profesionale kryhet në mënyrën e paraparë me rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme, të cilën e propozon Këshilli Drejtues i QKMF-së.
3. Mbikëqyrja e QKMF-së përfshin:
 - 3.1 Mbikëqyrjen dhe inspektimin e objekteve të KPSH për infrastrukturën dhe menaxhimin e objekteve.
 - 3.2 Mbikëqyrjen dhe inspektimin e ofrimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore, sipas normave dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.
 - 3.3 Mbikëqyrjen dhe monitorimin e raporteve dhe procedurave financiare, për menaxhimin e fondit të alokuar, të paraparë nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe rregullat e Prokurimit Publik.

Neni 26

Aktet e përgjithshme

1. Me propozim të Drejtorit të QKMF-së, Këshilli Drejtues i QKMF-së nxjerr këto akte nënligjore administrative të përgjithshme:
 - 1.1 Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
 - 1.2 Rregulloren për punë;
 - 1.3 Rregulloren për mbrojtjen në punë;
 - 1.4 Rregulloren për mbrojtjen kundër zjarrit;
 - 1.5 Rregulloren për kontabilitetin e brendshëm;
 - 1.6 Rregulloren për rendin shtëpiak;

- 1.7 Rregulloren për mbikëqyrjen dhe organizimin e brendshme;
- 1.8 Rregulloren për parandalimin e infeksioneve;
- 1.9 Rregullore të tjera për mbarëvajtjen e punës në QKMF-së.

Neni 27

Pronësia

1. QKMF-ja ka në shfrytëzim mjetet dhe pasurinë, e cila është pronë e Komunës së Suharekës.
2. QKMF-ja si institucion i KPSH është përvetësuese e fondit për financim nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga te hyrat vetanake të Komunës.
3. Pasurinë e QKMF e përbëjnë asetet, të drejtat dhe të mirat materiale, me të cilat QKMF-ja ka të drejtë të disponoj në pajtim me aktet ligjore në fuqi.

Neni 28

Buxheti

1. Çështjet buxhetore dhe financiare të QKMF-së administrohen në mënyrë transparente, në pajtim me legjislacionin në fuqi për përdorimin e fondeve nga Buxheti i Republikës së Kosovës, si dhe me të gjitha procedurat, në përputhje me udhëzuesit e Ministrisë së Financave.
2. Buxheti dhe llogaritë e QKMF-së përfshijnë tërë shpenzimet operative të njëjësive punuese.
3. QKMF-ja i nënshtrohet auditimit të brendshëm nga auditori i Komunës, ndërsa auditimit të jashtëm nga auditorët zyres kombëtare të auditimit në Prishtinë.

Neni 29

Financimi

1. QKMF-ja shfrytëzon burimet financiare në harmoni me Ligjin për Shëndetësi të Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, nga Buxheti i Republikës së Kosovës, Buxheti i Komunës dhe nga burimet e tjera, të parapara me ligjet përkatëse.
2. Procedura dhe forma e bashkë pagesës për shërbimet e ofruara në QKMF përcaktohet me akt nënligjor bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe aktet tjera nënligjor.

DISPOZITAT E VEÇANTA;

Neni 30

Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin

Ky Statut mundë të ndryshohet dhe plotësohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës në Suharekë duke e dhenë arsyetimin nga propozuesi përkatësisht këshilli drejtues i QKMF-së përmes Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Suharekës.

Neni 31
Shtojca

Aneksi 1 është pjesë përbërëse e këtij Statuti.

Neni 32
Dispozita kalimtare dhe shfuqizuese

1. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë të këtij Statuti mbeten aktet që janë në fuqi dhe që nuk janë në kundërshtim me këtë Statut.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet Statuti i QKMF-së në Suharekë, i miratuar në mars të vitit 2006.

Neni 33
Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky Statut hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË

01-Nr-016-12154
Me date 28.02.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Mr. Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d) nenit 17, lidhur me nenin 40, paragrafi 2 shkronja (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 2, të Ligjit Nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.27/2008”, e konform nenit 15 dhe 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 28.02.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

Për pagesën e shujtës për të gjithë nëpunësit në administratën e Komunës së Suharekës

Neni 1

- 1.1 **MIRATOHET**-kërkesa e shoqatës Sindikale e Pavarur të Administratës së Komunës në Suharekë, me numër të protokollit 01-Nr-104-7547 të datës 03.02.2022, për pagesën e shujtës për të gjithë nëpunësit në administratën e Komunës së Suharekës dhe atë në vlerë financiar nga **3,00€** në ditë (ditë pune) për secilin nëpunës veç e veç.
- 1.2 Mjetet lëshohen nga kategoria mallra dhe shërbime **kodi buxhetor 13620-Furnizimi me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)** e së cilës Drejtori veç e veç dhe zyres së Kryetarit ku nëpunësit janë të sistemuar dhe atë duke filluar së zbatuari nga 01.01.2022, pasi që mjetet janë të planifikuara.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtoret e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër, 01-Nr-016-36568, i datës 29.06.2021.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-12179
Me datë 28/02/2022



Kryesuesi Kuvendit
Mr. ec Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË-SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d) dhe nenit 40, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 15 dhe nenit 28 paragrafi 2 pika (a) lidhur me nenin 29 paragrafi 2 pika (d) të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datën 28.02.2022, miraton këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-61754

Neni 1

Me këtë vendim nga data 01.03.2022 bëhet ndërprerja e subvencionimit të qytetarëve të Komunës së Suharekës të infektuar me covid-19, si dhe subvencionimi i familjarëve të të vdekurve që kanë vdekur si pasojë e virusit COVID-19.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi nga data 01.03.2022 shfuqizohet vendimi me numër të protokollit 01-Nr-016-61754 të datës 23.12.2020 për subvencionimin e qytetarëve të Komunës së Suharekës të infektuar me covid-19, si dhe subvencionimi i familjarëve të të vdekurve që kanë vdekur si pasojë e virusit COVID-19.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr- 016-12149
Më datë 28/02/2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2, te Ligjit Nr. 06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019”, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2022, miraton këtë:

V E N D I M
Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për shqyrtimin e ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqur ofertuese, pas procesit te vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës.

Neni 2

Komisioni nga neni 1, (një) i këtij vendimi përbehet prej 5, (pesë) anëtarëve dhe do të ketë përbërje:

- 2.1 Edon SADIKAJ-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
- 2.2 Sheqerije ZYRAPI-----përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
- 2.3 Labinot HALITJAHA-----përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
- 2.4 Kymete BAJRAKTARI-----përfaqësuese nga Ekzekutivi i Komunës
- 2.5 Ismet GASHI-----përfaqësues nga sektori jo qeveritar

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësit e komisionit janë që të bëjë shqyrtimin e ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqur ofertuese, pas procesit te vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, ku komisioni lidhur me ankimin vendosi me vendim në këtë mënyrë;

- 3.1 **refuzimin e ankesës** dhe lënia në fuqi të procesit të vlerësimit final të ofertës
- 3.2 **miratimin e ankesës** dhe shfuqizimin, revokimin e procesit të vlerësimit final të ofertës.

Neni 4

4.1 Për punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë.

4.2 Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhen më shumë se 6, (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.



Neni 5

5.1 Mandati i anëtareve të Komisionit të ankesave është 2 (dy) vite brenda mandatit të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

5.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 6

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimit e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër, 01-Nr-016-41942, i datës 28.06.2019, për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-12166
Me datë 28/02/2022



Kryesuesi Kuvendit

Mr. ec Bexhet KUÇI





REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
THE MUNICIPALITY OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), lidhur me neni 17 të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e në mbështetje neneve 15 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2022, miraton këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste në objektin afarist-banesor që do të ndërtohet nga **Bashkim Sali HOXHAI** dhe **z. Sami Dervish ELSHANI** në parcelën kadastrale **P-72116046-01165-5**, të cilëve ju është dhënë në shfrytëzim me Vendimin e Kuvendit të Komunës në Suharekë 01-Nr-016-32543 të datës 29.07.2020 dhe sipas kontratës 01-Nr-016-37358 të datës 19.08.2020 për ndërtimin e objektit afarist-banesore, në këtë përbërje;

- 1.1. Shefket KOLGECI-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
- 1.2. Sanie KUÇI-REXHEPAJ-----përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
- 1.3. Festë KABASHI -----përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
- 1.4. Visar KUÇI-----përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
- 1.5. Armend KRASNIQI-----përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e komisioni janë që të bëjnë ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste që i takojnë Komunës në objektin që është duke u ndërtuar nga investitor e cekur më lart në parcelën e cekur në nenin 1 të këtij vendim dhe pas arritjes së marrëveshjes përfundimtare t'i rekomandojnë Kryetarit të Komunës që marrëveshjen ta miraton në Kuvendin e Komunës së Suharekës dhe tek atëherë nënshkruhet nga Kryetari i Komunës me palët investuese.

Neni 3

Autorizohet komisioni i lartcekur që pas ndarjes dhe definimit të banesave dhe lokaleve afariste që i takojnë Komunës, sipërfaqja e lokaleve afariste që i takojnë Komunës të shëndrrohen në banesa banimi për Komunën.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimit e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër te protokollit 01-Nr-016-40648 të datës 31.08.2020.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-12153
Me datë 28/02/2022



Kryesuesi Kuvendit

Mr. Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 te Statutit të Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008 e në mbështetje të nenit 6, të Udhëzimit administrativ (MASH) Nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimet e përkohshëm, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2022 miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit përzgjedhës

Neni 1

- 1.1 Formohet komisioni përzgjedhës për intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar në konkursin për drejtor/esh dhe zëvendës drejtor/esh të shkollave fillore të mesëm të ultë dhe fillore të mesëm të lartë, të shpallur nga Drejtorja e Arsimit.
- 1.2 Komisioni ka mandat për një vit shkollor 2021/2022 , dhe ka këtë përbërje:
 - 1.2.1 Agim RRAQI-----përfaqësues i DKA-së kryesues
 - 1.2.2 Arta HOTI-----përfaqësuese e këshillit të prindërve
 - 1.2.3 Anëtari i tretë vjen nga MASH-ti, sipas udhëzimit administrativ, Nr-151/2020.
 - 1.2.4 Anëtar dy përfaqësues të këshillit drejtues të institucionit edukativo-arsimor, një prind dhe një mësues në cilësinë e vëzhguesve pa të drejt vote në se cilin institucion ku është duke u zhvilluar procedura e konkursit.

Neni 2

Detyrë e këtij komisionit përzgjedhës është që të bëjë intervistimin e kandidatëve të cilit kanë konkurruar në këtë konkurs dhe në bazë të pikëve të fituar, bën ranglistën e kandidatëve dhe i rekomandon Kryetarit të Komunës për zgjedhjen e drejtorit të shkollës sipas konkurseve.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË

01-Nr- 016-12157
Më datë 28/02/2022





Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), te Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 13, të Rregullores mbi ndarjen e bursave për nxënës/e dhe student/e, të Komunës së Suharekë, 01-Nr-16-540, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën 28.02.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni nga anëtarët e Kuvendit të Komunës në Suharekë, për shqyrtimin e ankesave që paraqiten kundër vendimeve të komisionit për ndarjen e bursave, me këtë përbërje:

1. Mimoza BAJRAKTARI---përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës--anëtare
2. Aziz BYTYQI-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës--anëtar
3. Kushtrim KUÇI-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës---anëtar
4. Sheqerije ZYRAPI-----përfaqësuese nga Kuvendi i Komunë---anëtare
5. Qëndrim ELSHANI-----përfaqësues nga Kuvendi i Komunës---anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për shqyrtimin e ankesave, që paraqiten kundër vendimeve të komisionit për ndarjen e bursave, janë që të shqyrtojnë dhe të vendosin për ankesat e paraqitur.

Neni 3

3.1 Për punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë.

3.2 Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhën më shumë se 6, (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.

Neni 4

4.1 Mandat i anëtareve të komisionit komunal të aksionarëve zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

4.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-12173
Me datë 28/02/2022



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), te Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 5, të Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008” dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009 dhe konform nenit 15 dhe 29, pika 2, te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 28.02.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni komunal i aksionarëve nga Komuna e Suharekës për Ndërmarrjen Publike Lokale, “Ekoregjioni”, me këtë përbërje:

1. Sanie KUÇI-REXHEPAJ----- i emëruar nga Kuvendit Komunës-----anëtare
2. Shefket KOLGECI----- i emëruar nga Kuvendit Komunës-----anëtar
3. Herolind LIMAJ ----- i emëruar nga Kryetari Komunës-----anëtar

Neni 2

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësit e këtij komisioni janë të përcaktuar me Ligjin, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008” dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, lidhur me Ligjin Nr-02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-39/2008” dhe ligjet tjera që janë në fuqi.

Neni 3

3.1 Për punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Ndërmarrjes Publike Lokale “Ekoregjioni” Sh.A, me seli në Suharekë.

3.2 Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhen më shumë se 6, (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.

Neni 4

4.1 Mandat i anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

4.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016 - 12162
Me datë 28/02/2022



Kryesuesi i Kuvendit
[Signature]
Mr. ec Bexhet KUÇI